



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 01.11.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 27.10.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Botek" shpk lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informativë", Nr. i prokurimit- 632-23-5132-5-5-8, Nr. i brendshëm-632-23-060 -558, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Botek" shpk, e dt.27.10.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informativë", Nr. i prokurimit- 632-23-5132-5-5-8, Nr. i brendshëm-632-23-060 -558, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 25.10.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 25.10.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.27.10.2023, Operatori Ekonomik "Botek" shpk, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informativë", Nr. i prokurimit- 632-23-5132-5-5-8, Nr. i brendshëm-632-23-060 -558.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 01.11.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj nuk qëndron, sepse Autoriteti kontraktues në Ftesën për ofertim, ka kërkuar vetëm deklaratë për specifikimet teknike, të cilën Operatorët Ekonomik e kanë ofruar, mirëpo në Vendimin e

OSHP-së,-2023/0482, të dt.02.10.2023, është thënë se Autoriteti kontraktues ka bërë lëshim se nuk ka kërkuar specifikime më të detajuara ashtu siç ceket në Marrëveshjen kornizë të lidhur me AQP-në:

Në përgjigje të pretendimit të OE ankues lidhur me këtë çështje, vlerësojmë se problemi ka të bëjë me lëshimin e bërë nga AK në FPO që është dërguar te OE-të. Konkretisht kushtet e tenderit të përcaktuar në Nenin IV në FPO nuk pasqyrojnë kërkesat e Marrëveshjes Kornizë bazë, në të cilën specifikohet " Shënim:- Te plotësohen me saktësi dhe qartësi kolonat ne te djathte "Specifikacioni teknik minimal i ofruar" dhe secila informatë aty duhet të përputhet me katalogun te cilin e ofroni, pra gjithsecila informatë e plotësuar nga ju duhet te jete edhe ne katalog qe te mund te vërtetohet gjate vlerësimit. Ku kërkohet "minimumi" ose "or better" ju duhet te shkruani saktë se çfarë ofertoni ndërsa kur kërkesa është e prere si p.sh "Mausi dhe tastieri: USB Mouse & QWERTY Keyboard" ju mund ta plotësoni me "? ose x"

-Për secilin produkt duhet te specifikoni emrin e modelit qe e ofertoni. Ne kolonën e pare te secilit produkt tek - Prodhuesi - Brand Name dhe ne kolonën e fundit duhet te shkruani emrin e modelit duke përfshirë emrin e prodhuesit dhe emrin e saktë te modelit te cilin e ofroni.

- Sistemi operativ i ofruar duhet te jete i licencuar.

- Tek lapotopet duhet te ofronin çanta te cilat duhet te jene te njëjtit prodhues e përfshirë ne konfiguracion....."

Në një situatë të tillë AK duke mos specifikuar në FPO se dokumenti i specifikimeve teknike duhet të përfshijë edhe informatat për modelet dhe specifikimet e pajisjeve të ofertuara si dhe katalogun, si informata të cilat kërkohen nga kushtet e marrëveshjes bazë, ka lënë mundësinë që OE-të të ofertojnë pa dhënë informacion se me cilat produkte ofertojnë rrjedhimisht edhe krijon paqartësi në pranimin e pajisjeve duke e ditur që në procedurë konkretisht në kontratë nuk dihet se cili do të jetë modeli që duhet të liferohet, përkatësisht pranohet.

Në situatë të tillë, e vetmja rrugë për Autoritetin Kontraktues ka qenë anulimi i procedurës.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës